

SKEDË INFORMUESE

Thirrjen e hapur për projekte që mbështesin promovimin e veprimeve rajonale të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor (Faza II) nën Programin WBF

Synimi i thirrjes:

Thirrja vjetore e granteve e mbështetur nga Bashkimi Evropian është krijuar për të fuqizuar OSHC-të dhe ka në fokus të saj organizatat në të Ballkanin Perëndimor. Thirrja gjithashtu inkurajon krijimin e partneriteteve që do të përfshijnë Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) dhe/ose institucionet e përshkruara në entitetet e pranueshme (ndër to Bashkitë, Qarqet, apo Shoqatat e Bashkive). Nëpërmjet këtyre granteve, WBF synon të forcojë kohezionin rajonal, të rrisë bashkëpunimin midis palëve dhe të promovojë pjesëmarrjen aktive në iniciativat që çojnë përpara misionin e Fondit për integrimin dhe zhvillimin rajonal.

Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF), i krijuar nga Ministritë e Punëve të Jashtme të 6 shteteve të Ballkanit Perëndimor (WB6), shërben si një ndihmesë për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor.

Objektivat dhe fushat e ndërhyrjes:

Objektivi i përgjithshëm është të forcohet bashkëpunimi rajonal dhe demokracitë pjesëmarrëse në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Objektivat specifike përfshijnë:

- Krijimin e partneriteteve ndërmjet OSHC-ve në të gjithë rajonin për të punuar në sfidat e përbashkëta.
- Rritja e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe llojeve të ndryshme të pranueshme të mbështetjes.
- Promovimi i gjithëpërfshirjes duke mbështetur grupet e marginalizuara.

Rezultatet e pritshme përfshijnë:

- Krijimin dhe përforcimin e partneritetet rajonale duke adresuar sfidat e përbashkëta dhe duke arritur qëllime të përbashkëta.
- Rritjen e kapaciteteve të aktorëve rajonalë përmes aktiviteteve trajnuese, fushatave ndërgjegjësuere dhe kërkimit për zhvillimin e politikave që synojnë audienca specifike.
- Rritja e përfshirjes së grupeve të marginalizuara në aktivitetet rajonale, duke fuqizuar komunitetet e nën-përfaqësuar për të marrë role udhëheqëse.
- Rritja e gjithëpërfshirjes në organizata për të përfaqësuar më mirë nevojat dhe perspektivat e ndryshme të komuniteteve.

Projektet mund të mbulojnë një ose disa nga fushat e mëposhtme:

I. Bashkëpunimi kulturor:

II. Edukimi dhe shkëmbimet shkencore:

III. Zhvillimi i Qëndrueshëm

Përfituesit përfundimtarë janë komunitetet nga 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

- Për t'u kualifikuar për të aplikuar për grantin vjetor, aplikuesi kryesor duhet të jetë një entitet juridik, i themeluar në një ose më shumë Palë Kontraktuese të WBF dhe duhet të jetë jofitimprurës nga një nga kategoritë e mëposhtme:
 - Organizatë e Shoqërisë Civile (OSHC/OJF);
 - Një entitet publik vendor ose rajonal, ose shoqatë e enteve publike vendore ose rajonale;
 - Një shoqatë biznesi si: shoqatë e ndërmarrjeve, shoqatë bujqësore, dhomë e tregtisë;
 - Shoqata turistike, etj;
 - Një institucion arsimor si universitete/fakultete, shkolla, institute, biblioteka, qendra kërkimore,
 - Akademi të shkencës/muzikës/arteve etj;
 - Shoqatat mediatike si: organizatat që punojnë me median, gazetarinë dhe lirinë e shprehjes;
 - Një institucion kulturor ose sportiv, si muzetë, galeritë e artit, teatrot, bibliotekat;
 - ose shoqatat e institucioneve kulturore, shoqatat sportive, etj.
- Subjektet fitimprurëse, institucionet e Qeverisjes Qendrore, Partitë Politike dhe institucionet fetare nuk kanë të drejtë në këtë thirrje, as si aplikant kryesor dhe as si partner projekti.

Partneritetet janë një kërkesë thelbësore për të aplikuar në këtë Thirrje për Propozime. Partneritetet duhet të përfshijnë Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) dhe/ose institucionet, siç përshkruhet më lart. Çdo partneritet duhet të ketë një **(1) Aplikant Kryesor** dhe të paktën **dy (2) Partnerë Projekti** nga shtete të ndryshëm (shtetet që janë Palë Kontraktuese) të WBF. **Megjithatë, partneritetet e formuara nga më shumë se tre (3) CP inkurajohen të aplikojnë dhe do të kenë prioritet gjatë vlerësimit të propozimeve. Aktivitetet duhet të zhvillohen në shtetet Palë Kontraktuese të WBF (WB6).**

Sipas kësaj Thirrje për Propozim, një aplikant mund të aplikojë disa herë si Aplikant Kryesor ose të jetë Partner i Projektit në disa aplikime, megjithatë, mund t'i jepet vetëm **1 (një) grant (me pikët më të larta) si Aplikant kryesor dhe/ose 1 (një) grant (me pikët më të larta) si Partner i Projektit.**

Aktivitete të pranueshme:

Projekti duhet të përfshijë një sërë aktiviteteve që synojnë arritjen e objektivave të tij dhe maksimizimin e ndikimit të tij. Aktivitetet e projektit duhet të përfshijnë evente rajonale, fushata ndërgjegjësuëse dhe përpjekje për rrjetëzim, evente avokuese, të cilat

shërbejnë për mobilizimin e palëve të interesuara dhe informimin e tyre për misionin e projektit. Rekomandohet që çdo event të fokusohet në krijimin e një ndjenje komuniteti dhe shkëmbimi të praktikave të mira, nxitjen e frymës së bashkëpunimit midis anëtarëve të komunitetit.

Të gjitha aktivitetet DUHET të sigurojnë Balancë Rajonale dhe pjesëmarrje jodiskriminuese në evente. Propozimet e projektit duhet të marrin në konsideratë integrimin e çështjeve ndërsektoriale në nivel projekti dhe të paktën tre janë të detyrueshëm për të qenë pjesë e projekt propozimit. Gjatë zhvillimit të një projekti për të adresuar ndonjë nga objektivat specifike të thirrjes, çështjet ndërsektoriale duhet të përfshihen. Ju lutemi zgjidhni çështjet ndërsektoriale përkatëse që përshtaten në projektin tuaj:

- 1) **Axhenda e Gjellbër**
- 2) **Informimi Rajonal**
- 3) **Ndjeshmëria gjinore**
- 4) **Ndjeshmëria ndaj konfliktit**
- 5) **Ndarja e njohurive**
- 6) **Promovimi i grupeve të marginalizuara**
- 7) **Liria e Shprehjes**
- 8) **Integrimi në BE**
- 9) **Bashkimi mes palëve**
- 10) **Inovacioni dhe Dixhitalizimi**

Cili është buxheti i thirrjes dhe si është ndarë në prioritete:

Buxheti i përgjithshëm i thirrjes është **360,000 Euro**. Ndërveprimi i përbashkët mes BE dhe WBF do të respektojë dhe garantojë shpërndarje të balancuar të fondeve për secilën palë kontraktuese të Fondit të Ballkanit Perëndimor (BB6).

Buxheti për secilin projekt-propozim:

- WBF do të financojë grante për projekte deri në maksimumi **15,000 EUR**.
- Granti nuk duhet të kalojë **80% të kostove totale të pranueshme** të t.
- Shuma e bashkëfinancimit të kryer nga aplikanti nuk duhet të bjerë nën 20% të totalit të kostove të pranueshme të veprimit.

Projektet me nivele më të larta bashkëfinancimi do të kenë prioritet për financim për shkak të potencialit të tyre më të madh për ndikim. Një minimum prej 3,750 EUR kërkohet si bashkëfinancim nëse kërkohet shuma maksimale (15,000 EUR) e grantit. Shembull i formulës së bashkëfinancimit: Maks. Madhësia e Grantit (15,000 EUR) + 20% Bashkëfinancim (3,750 EUR) = Shuma totale e kostove të pranueshme (18,750 EUR)

Kohëzgjatja e projekteve:

Kohëzgjatja e projekteve nuk mund të jetë **më e ulët se 3 (tre) muaj** dhe as **më shumë se 6 (gjashtë) muaj**, duke përfshirë periudhën e raportimit (30 ditët e fundit brenda afatit të zbatimit).

Platforma e Partneritetit:

Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF) ka krijuar një Platformë Partneriteti në Facebook për të ndihmuar aplikantët të gjejnë partnerë të përshtatshëm të projektit në kontekstin e përgatitjes së kësaj Thirrje për Propozime. Ju lutemi kontrolloni <https://www.facebook.com/groups/WBFPartnershipPlatform/>

Si bëhet aplikimi:

Aplikuesit kryesorë ftohen të dorëzojnë aplikacionin e projektit në emër të partneritetit të krijuar, në gjuhën angleze, duke përdorur Sistemin Online të Menaxhimit të Granteve (OGMS). Sistemi online ofron informacion të detajuar në lidhje me Anekset që do të përfshihen në Sistem për të bërë aplikimin:

1. Aneksi A – Formulari i Aplikimit
2. Aneksi B – Buxheti
3. Aneksi C – Deklarata nga Aplikuesit Kryesor (që do të nënshkruhet dhe vuloset)

Aplikimi i projektit duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike në faqen e mëposhtme të internetit: <https://wbportal.org/applicant/login.html>

Kur është afati i fundit:

- Afati i fundit: **19 Shkurt 2025, ora 23:59 CET (ora)**

Deri kur mund të dërgohen kërkesat për informacion:

Kërkesat për informacion në lidhje me këtë thirrje mund të dërgohen me e-mail jo më vonë se 15 ditë përpara afatit në adresën e mëposhtme të postës elektronike: info@westernbalkansfund.org Përgjigjet do të përmbliidhen dhe do të publikohen jo më vonë se 10 ditë përpara afatit të fundit për dorëzimin e projekt-propozimeve në faqen e internetit të WBF.

Nëse keni nevojë për më shumë informacion ose ndihmë shtesë mbi këtë thirrje, na njoftoni!